

BESIMTARI

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti II i botimit, Shtator 2008 Nr. 17. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj



THIRRJE E HAPUR MEDIATIKE PER KONVERTIMIN E MUSLIMANEVE SHQIPTARE NE TE KRISHTERE KATOLIKE

Në një emision informative në Tv Cnenell, telespektatorët u njohën me një lajm që nuk ishte pare në asnjë media të shkruar dhe vizive ,sipas të cilit, në fshatin Istog të Kosovës, një familje muslimane ishte konvertuar në të krishterë, ku 19 anëtarë të saj tashti do të ishin prone e kishës katolike, e thënë pak ndryshe, anëtarët e familjes Mehaj kishin ndërruar pronarët fetarë duke kaluar nga hoxha tek prifti, me të cilin, ata dhe të gjithë shqiptarët ,sipas Topit, kishin lidhje që në lashtësi. Pasi u muar vesh sa ishte numuri i të konvertuarve, në ekran doli prifti katolik I Dioqezës së Glinës që deklaroi se tufës së tij iu shtuan dele të tjera dhe se sipas tij, tashti shqiptarët nuk janë më injorantë, por janë civilizuar dhe e kanë kuptuar se ku i kanë rrënjët dhe për këtë arsye duhet të kthehen në fenë e të parëve si familja Mehaj, që e gjeti rrugën e vërtetë. Ai shtoi se ka shumë familje në Kosovë që po presin të kthehen në të krishterë katolikë, duke iu bashkangjitur fesë së të parëve, një përrallë e dalur boje kjo, për të mbuluar diversionin që bëhet në kuadër të një rikonkuiste pak më të butë se ajo që bëri Filipi dhe Izabela në Spanjë kundër muslimanëve spanjollë, të cilët u tkurrën në mënyrën më dhunshme. Një njeri mund të konvertohet dhe mund të ndiqet në këtë konvertim nga familja dhe nga mijra të tjerë ,sepse është e drejta e secilit të zgjedhe religionin ku ai e ndjen veshen të rehatuar dhe për këtë askush nuk ka përse të shqetësohet . Por, ana e rrezikshme e këtij informacioni është se ai nuk ka përse të behet mediatik , aq më teper të bëhet me ceremoni të organizuara ,sikur të ishte një feste ku pa tjetër duhej të ishte edhe korespondenti i Topit në Kosovë, duke u kujtuar muslimanëve se ata kanë vetëm një alternative shpëtimi, që është kthimi i tyre në të krishterë katolikë dhe se ata duhet të shpejtojnë, që tu bash-

kangjiten familjeve Mehaj , Mahmudaj ,ose të ndonjë familjes tjetër që rri zgjuar natën, deri sa ta pagëzojë prifti i Glinës.Është e kuptueshme se ka pasur reagime në mediat e shkruara për këtë skandal të rrezikshëm që cënon tolerancën fetare në mes të shqiptarëve. Dhe pendat që u përgjigjen janë Mehdi Hyseni dhe Qemal Morina të cilët, trumbetimin e këtij akti e quajtën të dëmshëm, sepse Kosova ka probleme shumë më të mbrehta se thirrja për të shkuar 90 % e kosovarëve pas 1% që përfaqësojë katolikët sot në Kosovë.Dalja kaq hapur dhe venia në dispozicion e mediave për të bërë propogandë kaq të hapur për konvertimin e muslimanëve shqiptarë në katolikë, si kthim në fenë e të parëve, tregon se këtu nuk është punë e priftit të Glinës , por fijet e kësaj ceremonie të mirëorganizuar shkojnë më larg se në Kosovë, aty ku hapësirat muslimane po penalizohen dhe po bëhet e pamundura që ata të zvoglohen drejt infinitit. Por, organizatorët e këtyre ceremonive mortore kundër muslimanëve shqiptarë janë larg realitetit, sepse muslimanët shqiptarë janë të rehatuar mrenda fesë islame dhe konvertimi i tyre në të krishterë është çështje e tyre personale dhe e ndërgjegjës së tyre . Ceremoni dhe shtërngesa politike , vështirësi ekonomike dhe literature kishtare nuk mjaftojnë për të përmbysur raportet fetare në mes të shqiptarëve në Kosovë dhe në hapësira të tjera shqiptare.Mendojmë se konvertimi i muslimanëve shqiptarë në të krishterë katolikë është vështirë për tu realizuar edhe për një arsye tjetër,sepse kisha katolike ka probleme me portretin e saj moral. Tashmë janë shumë të njohura publikishi mijra raste të podofilisë në mes të priftërinjve katolikë për të cilët Vatikani ka paguar 650 milion dollarë për të dëmtuarit nga këto akte të rënda morale, duke shtuar rastin e para pak ditëve , kur një prfti katolik në Angli iu gjetën mijra fotografi podofilie. Është e qar-

të se pas këtyre drejtuesve fetarë ,që marrin nëpër këmbë normat morale fetare është thujse e pamundur që angazhohen ata që duan të konvertohen në religionin katolik, në një kohë që, për raste të tilla, tek udhëheqësit fetarë muslimanë ,as që bëhet fjalë. Të mos harrojmë se janë me mijra konvertime nga fetë e tjera në fenë muslimane, e cila sot rrallitet e para për numurin e të konvertuarve në shtimin e rrallëve të saj. Por, lajme dhe ceremoni nuk janë dhënë në media, kur figura të njohura politike , shoqerore dhe fetare janë kthyer në muslimanë. Duket se ustallarëve, qe pompojnë për qellime dashakeqe rastet e rralla të konvertimeve të muslimanëve në të krishterë, u intereson një terr i plotë informative, kur rrallët e muslimanëve shtohen me të krishterë. Është e domozdoshme që shoqatat muslimane , institucionet fetare islame dhe shoqëria civile të mbajë qëndrim ndaj këtyre informacioneve dhe ceremonive që janë me qitje të largët antimuslimane, duke i demaskuar ata, që janë në vijën e pare dhe ata që janë në vijën e dytë e më tej,sepse veprime të tilla e nxerrim tymin dhe flakën atëherë, kur ne e kemi harruar lajmin për ceremoninë e kthimit të muslimanëve shqiptarë në të krishterë katolikë.Në përkthimin e Kur-anit Famëlartë, të botuar në vitet 90, është paralajmëruar rreziku i kthimit të muslimanëve shqiptarë në të krishterë,mendim që ishte botuar në parathënieën e këtij libri hyjnor nga Ahmed Raif, drejtor i një qendre të madhe islame në Kajro të Egjiptit.Sot, pas dy dekadash, muslimanët shqiptarë po e shohin qartë përpjekjen, që po bëhet në terren për ti larguar ata nga feja islame, ku ceremonitë nuk mungojnë, ku mediat çirren duke deklaruar për përqindje të zvogluara të muslimanëve në hapësirat ku jetojnë shqiptarë muslimanë,duke bërë thirrje që të bëhet një rregjistrim i ri i popullsisë, ku elementi fetar mos të jetë i përjashtuar. Por, euforia e

mediave shqiptare për konvertimin e disa familjeve muslimane në Kosovë në të krishterë katolikë dhe thirrja e priftit të Dioqezës së Glinës, për të nxitë muslimanët në Kosovë e më gjërë, që të heqin dorë nga feja islame për të qenë pjesë e religionit katolik, nuk është e mjaftueshme për të përmbysur raportet fetare në hapësirat shqiptare ,sepse feja islame është bërë e pranueshme nga shqiptarët si alternative shpëtimin nga kisha e krishterë serbe dhe greke dhe se islami u ka rritur shqiptarëve përkushtimin tek dashuria për atdhe ,për shkak se, sipas islamit, dashuria për atdhe për muslimanin buron nga feja islame. Shqiptarët muslimanë nuk mund të gjejnë avantazhe tek religjoni katolik, të cilat atij i mungojnë tek feja islame . Të vendosura në një peshore vlerash të dy religjonet, do ta kishim të vështirë të shikonim se nga do të anonte ajo për ti dhënë vendin e pare njërës pale. Por diçka është e qarte.Muslimanët janë të vlerësuar maksimalisht për dashurinë e tyre sublime për atdhe , jane shumë të nderuar për një moral të pastër familjar dhe shoqëror, janë të nderuar për një pastërti absolute personale ,familjare dhe shoqërore. Atëherë përse duhet të braktisim këto vlera të fesë islame dhe të kthehemi prapa, kur prapa gjithmonë është regresi? Mendojmë se prifti I Glinës dhe ata, që janë pas tij ,pa harruar dhe Topin që çensuron deklaratat e shoqatave muslimane, duhet të japin përgjigje për sa pyetëm më lart. Nuk duhet harruar se lojra të tilla me konvertime muslimanësh në të krishterë, nuk do të jenë fitimprurëse as për të konvertuarit , as për ata që krijojnë re të tilla pluhuri, që mund të kthehen në stuhi, ku të lagurit do të jene shumë.

Selim Gokaj

GËZUAR MUAJIN E MADHËRUESHEM TE RAMAZANIT

Mirësia e muajit të Ramazanit në optikën e haditheve profetike.

Vlerat e miresite e shumta te ketij muaji te madhnueshem e bejne Ramazanin muajin me te privilegjuar ndaj muajve te tjere te vitit. Kjo gje verehet ne hadithet profetike te shumta. Miresia me e madhe ka te beje me perzgjedhjen, e ketij muaji nga Allahu i Madheruar per zbritjen e fjales se Tij, shpalljes hyjnore. Transmetohet nga Profeti a.s. se fletushkat e Ibrahimit a.s. kane zbritur ditën e pare te Ramazanit, Teurati i ka zbritur Musait a.s. ditën e gjashte, Zeburi i ka zbritur Davudit a.s. ditën e dymbëdhjete, Inxhili i ka zbritur Isait a.s. ditën e tetëmbëdhjete. Ndersa, Kurani i ka zbritur Muhamedit

e mire se nje mije muaj. Kush privohet nga ajo, do te jete i privuar nga diçka e madhe. [Ahmedi dhe Nesai]. Ky prezentim, qe Profeti a.s. i beri Ramazanit, beri qe, per besimtarete e devotshem, agjerimi te mos ishte thjesht nje veper qe i privonte nga te ngrenit, apo te pirit, por mbi te gjitha kulture qe nguliste tek njeriu besimin, dashurine, shpresen, humanizmin e devotshmerine. Per kete culture, nese skalitet ne shpirtin e besimtarit, Allahu xh. sh. u premtoi faljen e mekateve te bera. Ne lidhje me kete, Pejgamberi a.s. ka thene; Ai qe agjeron Ramazanin me bindje dhe shprese per shperblim nga Allahu, atehere i falen mekate qe ka bere [Mut' tefikun alejhi]. Miresia e Allahut xh.

alejhi]. Ne kete muaj besimtarete duhet te angazhohen ne pune te mira per te qene sa me afer Allahut xh. sh. me adhurimin e tyre. Hasan El-Basri ka thene; Kerkoni kenaqesi ne tri gjera; me nemaz, ne te kujtuarit e Allahut dhe me leximin e Kur'anit, e nese nuk e gjeni dijeni se dyert u jane mbyllur. Allahu xh. sh. me perkujdesjen e Tij, e ka stolitur gjuhen e atyre sic do te pajise me drite syte e besimtareve qe do ta shikojne. Ramazani qe eshte muaj i meshires, faljes, e i shpetimit nga zjarri. Allahu xh. sh. do te kete meshire e falje mekatesh, per ata qe e respektojne dhe e njohin madheshine e vleren e ketij muaji te shenjte. Mjere ai qe e nenvlereson duke e pritur njelloj si muajt e tjere ditet e tij duke i konsideruar si dicka rutine, si ditet e tjera. Profeti a. s. e shprehu kete shqetesim qe, transmetohet se ne nje rast kerkoi qe te sillnin minberin. Kur ia sollen, u ngrit ngadale nga shkalla e pare ne te treten, duke i drejtuar me ze te larte te gjithëve; Amin.

Pastaj, kur zbriti nga minberi, shoket i thane; O i Derguar i Allahut. Sot kemi degjuar nga ti dicka qe nuk e kemi degjuar me pare. "Pra, e keni degjuar" - u tha Profeti a.s. dhe vazhdoi; Shikoni! Ndersa po ngjisja shkallet, Xhibrili a.s. me erdhi te kemba e pare e shkalles dhe me tha; Eshte larg nga rruga e drejte ai qe nuk e agjeron Ramazanin dhe mekate e tij nuk do te falen, dhe une i thashe; Amin... [Iben Hiban]. Ky muaj ka ardhur me nje qellim te vetem qe besimtarete duhet ta mesojne e ta pervesojne te behen te devotshem. Pra, behet fjale per nje grade te larte te besimit, nga e cila duhet kuptuar jeta ne kete bote. Parim esencial per besimtarin ne jeten e tij, qe Embron ate nga kanceri i unit, malarja e hipokrizise, e paragjykimit i ndricon mendjen se punet duhen te behen me mire, dhe konceptet e gabuara duhen korigjuar ... Eshte ky muaj i cili vendos nje lidhje te fshehte mes njeriut dhe Allahut xh. sh., lidhje e cila mbahet nga ndjenja e besimit te sinqerte. Mos harroni, qe ti jepni repektin e duhur ketij muaji, qellimit te ardhjes se tij, nese vertete kerkoni shperblim. Allahu pranon vetem prej te sinqerteve [El-Maide 27].

a.s. ditën e njetzet e katert te Ramazanit. [Ahmedi]. Veç kesaj, Allahu xh. sh. preferoi qe nje prej pese shtyllave, ne te cilat qendron Islami, agjerimin, ta obligoje per besimtarete ne kete muaj te begate. Per kete, Allahu xh. sh. urdheron e thote; kush prej jush e perjeton kete muaj, ta agjeroje.... [Bekare 185]. Besimtarete e devotshem, kudo ne bote, e presin me gezim te madhe ardhjen e ketij muaji te shenjte. Ky gezim i tyre ka te beje me pergjigjen ndaj thirrjes se Allahut xh. sh., dhe me respektimin e fjales se Profetit a.s. ne prezentimin qe i beri ardhjes se ketij muaji. Ebu Hurejra transmeton se Profeti a.s. ka thene; Po vjen nje muaj i bekuar, ne cilin Allahu ju ka bere obligim agjerimin. Gjate ketij muaji, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e zjarrit dhe lidhen shejtanet. Ne te eshte nje nate me

sh. ndaj atyre, qe e agjerojne kete muaj, verehet ne premtimin e respektit dhe shperblimit te tyre. Kete e pohon Profeti a.s. duke thene; Vertet ne Xhenet eshte nje porte qe quhet Er-Rejan. Ditën e Gjykimit, ata qe agjeruan, do te hyjne neper te, pervec atyre nuk hyn asnje tjeter, dhe kur te hyje i fundit agjerues, ajo do te mbyllet. [Transmeton Iben Huzejme]. Ramazani eshte per besimtarete muaj i bujarise dhe i kujtimit te Allahut me shume se cdo muaj tjeter. Ne lidhje me kete, Iben Abasi thote; Profeti a.s. ishte me bujari, por kur vinte Ramazani, ishte edhe me bujar, sepse takohej me Xhebrilin a.s. per te studiuar Kur'anin. I derguari i Allahut ishte edhe me bujar se era qe sjell miresi. Ndersa vitin e fundit te jetes se te derguarit te Allahut, ata e studiuane Kur'anin dy here. [Mut' tefikun

Idmir Plaku .

Teolog, imami i xhamise

Ebu Beker



SI T'I QASEMI KUR'ANIT FAMEMADH?

Dr. Ali F. Iljazi

Allahu i madhërishëm në Kur'anin fisnik urdhëron e thotë:

“ Është e vërtetë se ky Kur'an udhëzon për atë rrugë që është më se e vërteta, e besimtarët që bëjnë vepra të mira i përgëzon se ata pa dyshim do të kenë shpërblim të madh”. (El Isra, 9)

“ Ne të shpallim Kur'anin që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse jobesimtarëvenuk u shton tjetër përpos dëshpërim.” (El Isra, 82)

Sikur të gjithë drutë në tokë të jenë lapsa dhe sikur detit t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë me ngjyrë), nuk do të mbaronin fjalët e Allahut (do të shteroheshin detet, do të soseshin lapsat, e jo mrekullitë e Zotit). Allahu është ngadhënjyesi i urtë”. (Llukman, 27)

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ibadeti më i mirë i Ummetit tim është leximi i Kur'anit” – dhe thotë: “Sikur Kur'anit të ishte i shkruar në lëkurën e parexhur, zjarri nuk do ta digjte”.

Gjithashtu thotë: “Nuk ka ndërmyjetësues më të mirë ditën e Gjykimit, te Allahu, se Kur'anit, as nga Pejgamberët s.a.v.s., melekët ose dikush tjetër”.

Kupto se leximi i Kur'anit i ka rregullat e tij dhe fshehtësitë.

Rregullat e jashtme janë tre:

Ta lexosh me respekt dhe nderim. Pozita e respektit ndaj Kur'anit fisnik është që ta lexosh me abdest, i qetë, i kthyer kah kibla, jo i mbështetur, jo këmbëkryq, apo duke qenë i përgjumshëm. Duhet ta lexosh me kujdes duke theksuar çdo (germë) shkronjë dhe jo shpejtë. Ibn Abbasi r.a. ka thënë: “Të lexoj kaptinat »Zilzal« dhe »Kariah« duke menduar për kuptimin e tyre, për mua është më e dashur se leximi i shpejtë i kaptinave »Bekare« dhe »Ali Imran«. Kohë pas kohe ta lexosh në këmbë në namaz, e sidomos në xhami natën, sepse zemra natën është më e pastër dhe jo e ngarkuar me mendime. Për këtë Allahu xh.sh. i ka lavdëruar duke thënë: “Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë...” (Ali Imran, 191). Imam Aliu r.a. ka thënë: “Kush lexon Kur'an në këmbë gjatë namazit për çdo shkronjë i ka njëqind thevape, kush lexon Kur'an jasht namazit me abdest, për çdo shkronjë i ka 25 thevape, dhe kush lexon pa abdest i ka dhjetë thevape.

Shkalla më e ulët e leximit është që hatma të bëhet çdo muaj, ndërsa më e larta që hatma të bëhet çdo tre ditë. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kush e lexon Kur'anin për më pak se tre ditë nuk e ka kuptuar”. Mesi në mes këtyre dy gjendjeve është që Kur'anit të përfundohet çdo javë, ndërsa leximi i hatmes për çdo ditë nuk është e lavdëruar. Ilaçi është i dobishëm për të sëmurin, por dozimi i tepërt (predozimi) mund të jetë vdekjeprurës.

Fshehtësitë e leximit janë pesë:

Fillimisht të jesh i vetëdijshëm se Kur'anit është fjalë madhështore e përkryer, sikur që është i Lartëmadhëruar Ai i cili e ka shpallur dhe kështu në zemër të paramendosh Arshin, Kursin, qiejt, Tokën dhe çfarë gjendet në mes tyre, melekët, exhinët, njerëzit, kafshët, bimët, mineralet, duke menduar se ato kanë një Krijues, të cilit i binden të gjithë. Duhet të mendosh dhe dëshirosh që të mësosh fjalën e Tij, dhe nëpërmes fjalës së Tij të shikosh cilësitë e Tij, duke zbuluar bukurinë e diturisë dhe urtësisë së Tij. Gjithashtu, sikur që Kur'anit nuk mund të preket pa pastërtinë e jashtme, ashtu edhe zemra duhet të jetë e pastër. Nga frikërespekti Ikrime kur e hapte Kur'anin i binte të fikët duke thënë: “Kjo është fjalë e Zotit tim”. Dije se shkëlqimin e fjalës madhështore të Allahut xh.sh., sikur mos të ishte e mbuluar me shkronja, fuqia e njeriut nuk do të mund ta duronte dëgjimin e tij, për shkak të lartëmadhërisë së tij, shprehjes dhe ndriçimit të tij. Sikur Allahu xh.sh. mos ta fuqizonte Musain a.s. nuk do të mund ta dëgjonte fjalën e Tij të liruar nga shkronjat dhe zëri, mu sikur kodra që nuk mundi ta përballoj paraqitjen e Tij dhe u bë pluhur. Për këtë Allahu xh.sh. thotë: “Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur'an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të struktur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këta janë shembuj që ua shkoqsim njerëzve, që ata të mendojnë”. (El Hashr, 21). Ta lexosh duke menduar për kuptimin e tij. Imam Aliu r.a. ka thënë: “Nuk ka dobi nga ibadeti pa kuptim, si dhe nga leximi pa meditim”. Ruaju e mos u kreno se ke lexuar shumë hatme, sepse një ajet nëse e lexon gjatë natës duke menduar për kuptimin e tij është më e vlefshme se sa me lexuar dy hatme. Pejgamberi s.a.v.s. lexonte »Bismilahirr – Rrahmanir – Rrahim« Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirbërësit, dhe këtë e përsëriste njëzet herë. Ebu Derda r.a. ka thënë: “Njëherë Pejgamberi s.a.v.s. u ngrit me ne në namazin e natës duke e përsëritur pa ndërprerë ajetin: »Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti« (El Maide, 118). Temim ed Darij r.a. tërë natën e kaloi duke e përsëritur ajetin: »A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdekjen e tyre do t'i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar është gjykimi i tyre?» (Xhathije, 21). Seid bin Xhuberi r.a. tërë natën kaloi duke lexuar ajetin: »E tash, o ju kriminelë, ndahuni!« (Ja Sin, 59). Një dijetar kishte thënë: “Çdo javë bëjë hatme, çdo muaj bëjë hatme, çdo vit bëjë hatme, por kam hatme që e kam filluar para 30 viteve dhe ende nuk e kam përfunduar”. Në mendimet tua të korrish frutat e njohjes nga degët e saj, duke kërkuar margaritarët e dëshiruar. Mos e shi-



ko Kur'anin vetëm nga një prizëm. Të lirohesh nga ajo që të pengon të kuptuarit e tij, e këto janë perdet. I Lartësuari thotë: “Ka prej tyre që ty të dëgjonë (kur lexon Kur'anin). Po Ne kemi krijuar mbulesë mbi zemrat e tyre që të mos e kuptojnë atë...” (El En'amë, 25). Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Sikur shejtanët mos të mbulonin zemrat e njerëzve ata do të shihnin atë çfarë ndodhë në qiej”. Dije se kuptimi i fshehtë i Kur'anit është nga bota e fshehtë, ndërsa shkronjat janë nga bota e dukshme. Tek disa ekzistojnë perdet e dyshimit, tek disa perdet e dunjasë e te disa perdet e epsheve të cilat i mbulojnë zemrën. Mu për këtë është e qartë, përse nuk mund të arrijnë kuptimin e Kur'anit dhe dritën e tij. Me këto perde shumica janë të mbuluar. Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kur'anit ka kuptimin e jashtëm dhe të brendshëm, të kufizuar dhe të pakufizuar”. Ai i cili kufizohet me kuptimin e jashtëm, atëherë është e pamundur që t'i zbulohen të fshehtat e Kur'anit. Si mund t'i kuptojë fjalët e Allahut xh.sh. »Nuk do të më shohësh«, dhe si do të kuptojë se në këtë botë nuk mund ta shohë me këta sy që janë të kufizuar në hapsirë. Dhe si do t'i koordinojnë fjalët e Allahut të madhërishëm: “Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai i përfshinë të parët”. (El En'amë, 103). Me fjalët: “Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara). Që Zotin e tyre e shikojnë.” (El Kijame, 22 – 23). Të mjafton ky shembull që të kuptosh realitetin. Të lexosh ajetet e Kur'anit fisnik duke u pajisur me cilësitë e atij ajeti, dhe nga çdo kuptim të formosh gjendje (hal) të re. P.sh. kur përmendet mëshira, falja, të jesh i gëzuar sikur me qenë në krahët e lumturisë, ndërsa kur përmendet hidhërimi, ashpërsia e dënimit, të jesh i frikësuar si në vdekje. Kur përmendet Allahu xh.sh., emrat e Tij dhe Lartëmadhëria

e Tij, të ulësh kokën të strukesh sikur të mos ekzistosh fare nga ndjenja e Fuqisë dhe Madhështisë së Tij. Kur përmenden pabesimtarët ose ata që i përshkruajnë Zotit fëmij ose ortak, të ulësh zërin, të rrënohesh nga turpi ndaj Allahut xh.sh. Leximin ta shoqërosh me vaj, turp, dridhje e djersitje, rrënoqthje të lëkurës nga frikërespekti i fjalës së Allahut xh.sh. Pra mundohu që gjatë leximit të merr pjesë tërë organizmi, sepse Kur'anit i plotëson tri botët tuaja; botën psikike, shpirtërore dhe botën fizike. Dije se drita e pastër e njohurisë shkëlqen nga bota hyjnore në zemër. Andaj lumturia, frika, frikërespekti dhe gjendjet tjera janë nga bota psikike dhe vendi i tyre është krahërori. Nëse mendon në zemrën si një copë mishi, atëherë je largë nga njohja e brendisë, sepse kjo zemër, si një copë mishi gjendet te kafshët dhe te ngordhësitat, por në ato zemra nuk zbret drita e njohurisë dhe diturisë si dhe nuk pasqyrohet frika, devotshmëria dhe lumturia. Andaj nëse dëshiron të shijosh diçka nga këto fshehtësi, e unë e di se dëshiron, por shejtani të ngulfatë me litarin e epsheve, andaj ke kujdes në Tevhid. Dije se Kur'anit është sikurse Dielli, nga i cili rrjedhin fshehtësitë e njohjes në zemër, mu sikur rrezet e Diellit që bijnë në tokë duke i dhënë jetë. Frikërespekti është një gjurmë e dritës së njohjes dhe Allahut xh.sh. më së shumti i frikësohen të diturit. Mundohu që zemrën tënde ta kthesh kah dielli i Kur'anit, duke u ndriçuar me shkëlqimin e tij. Dëgjo thirrjen e cila vjen kah ana e djathtë e Turit dhe kur të shohësh shkëlqimin e zjarrit, merr një dru dhe ndize llampën dhe nëse e ke vajin si duhet do të ndiçojë pa e prekur zjarri, dhe ajo dritë do të jetë udhëzuese për ty mu sikurse Dielli i zjarrtë i cili shkëlqen pa pra. Përqafoje fuqishëm me tërë qenien tënde dritën e Allahut xh.sh.

PERSE SHTETI SHQIPTAR NUK I JEP MEDALJE DHE TITUJ NDERI NENE TEREZES

Në muajin gusht 2008, gazeta britanike "Dejli Telegraf" botoi te dhënat e një ankete ku, u dha një liste me më të njohurit për kontributin e tyre në dobi të çështjes së njerëzimit. Të dhenat treguan se vendin e pare e zuri bamirësja me origjinë shqiptare, Nënë Tereza, e cila u shpall personaliteti më i shquar ne historinë e njerëzimit. Gazetari Ndue Ukaj, nga Kosova, me të drejte shprehet me superlativa për këtë vlerësim, duke bërë një shkrim interesant në gazetën kosovare "Ekspres". Ai shkruan se bamirësja me origjinë shqiptare la pas, ne kete klasifikim, figura të njohura botërore si: Çurçilli, Martin Luter King e figura të tjera te njohura për kontributin e tyre ne dobi të çështjes së njerëzimit. Por, gazetari kosovar ankohet me të drejtë se mediat e shkruara dhe vizive i dhane shumë pak hapësirë kësaj ngjarjeje kaq të rëndësishme për shqiptarët, qe vazhdojnë të marrin vetëm informacione vulgare dhe komercia-

le, duke qëndruar larg këtyre lajmeve, qe evidentojnë figura të tilla si kjo bamirëse e njohur në të gjithë botën. Por, shqetësimi i Ndue Ukaj ecën edhe më tej, sepse ai habitet edhe për një heshtje të çuditshme nga institucionet shtetërore shqiptare, të cilat nuk duhet të anashkalojnë lajme të tilla të kësaj kategorie, në një kohë qe kjo zonjë e nderuar ka deklaruar në mënyre publike se është me origjinë shqiptare. Por, ajo qe është misterioze, ka të bëjë me atë se cila është arsyeja e vërtetë qe Nënë Tereza nuk nderohet zyrtarisht nga qeverite shqiptare për t'i dhënë asaj dekorata dhe tituj nderi, në se ka dhënë me të vërtetë kontribut për Shqipërinë dhe për shqiptarët. Ne kemi parë buste, postera, emërtime rrugësh dhe institucionesh me emërin e kësaj bamirëseje, por një vlerësim zyrtar me dekorata dhe tituj nderi do të ishte i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm. Në këtë mënyrë do të bëhej publik raporti i vërtetë i saj me Shqipërinë dhe shqiptarët. Ne e kemi të qartë se shtetit shqiptar nuk i mungojnë

medaljet, as nuk i mungon dëshira për ta nderuar zyrtarisht këtë zonjë te nderuar, por ai duhet të ketë një arsye të forte qe hesht zyrtarisht për ta vlerësuar atë, së paku me një dekorate për kontributin e saj për Shqipërinë dhe shqiptarët, gjithmonë në se Nënë Tereza ka dhënë një kontribut të tillë. Por, ka shumë mundësi qe, të drejtën për ta vlerësuar zyrtarisht e ka Vatikani i cili e ka nderuar me tituj të lartë fetarë për kontributin e saj në propogandimin dhe përhapjen e fesë katolike permes akteve bamirëse si murgeshë katolike qe ka qenë. Vetë Papa dhe personalitete të larta të kësaj herarkie e kane çuar këtë vlerësim deri tek shenjtërimi i saj, si maksimumi fetar i këtij religjoni. Prandaj, shteti shqiptar nuk ka të drejtë të ecë me tej se bustet dhe posterat në vlerësimin e figurës së kësaj bamirëse, megjithëse ajo ka origjinë shqiptare. Por, ata, qe e renditën të parën në anketën e gazetës "Dejli Telegraf", e quajtën një murgeshë romane -katolike. Prandaj, gazetari nga Kosova, Ndue Ukaj, nuk ka përse shqetëso-

het shume qe mediat dhe politika shqiptare e kaluan ne heshtje vlerësimin e fundit për këtë zonjë të nderuar. Sepse kontributi i saj bamires dhe aktivitetet e tjera të saj nuk kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët, por me qendrën e religjonit të saj, i cili e ka financiar fuqishëm edhe e ka vlerësuar pa kursim dhe vazhdimisht edhe pas vdekjes së saj. Qeveritë shqiptare nuk kane nguruar asnjë here të japin medalje dhe tituj nderi për figura dhe personalitete qe kanë kontribuar në fusha të ndryshme për Shqipërinë dhe shqiptarët. Duket se me Nënë Terezën janë mjaftuar me buste, postera, emertime institucionesh dhe rrugësh, sepse e kanë pasë të pamundur qe të shohin së paku një kontribut të saj për atdheun dhe popullin e vet, qe të justifikojnë një medalje dhe një titull nder nga shteti shqiptar për këtë bamirëse te njohur në të gjithë botën.

Selim Gokaj

OSO KUKA SHEHID

Nga madhështia e Kullës në Vraninë,
Gjithmonë dridhen shkja e shkinë.
Oso Kuka aty shehid ra.
Shpirtin dhuratë e bani për Allah.
Në atë ishull të vogël në Vraninë,
Shpirti i flijimit lëshon shkëndinë.
Ajo asht shkëndia e Muxhahidit,
Dritë qe i jepet vetëm shehidit.
Lakmi ua kanë Hanë e Diell,
Edhe yjet larg atje në qiell.
Njeni digjet, tjetri shndrit,
Por asnjëni kurrë s'bie shehit.
Se shehid bie veç mumini,
Për në xhenet xhahadi i prini.
Liqeni, Kulla edhe baroti,
Xhevahir janë shndërrue te Zoti.
Gurët e Kullës në perla shndërrue,
Gjaku i Osos në kandil ndriçue.
Në kandil të Rrahmanit,
Voji i tij nga pema e Islamit.
Dritë e shpresë gjithkah hidhet,
Sa të jete jeta shkja do t' dridhet.
Osa Kuka ka ra shehid.
Nuk ka vdek por gjithmonë ndrit.
Me legjenda pagane s'krahasohet,
Sixhadeja n' xhenet nga meleqet i shtrohet.
Osa Kuka me burra tjerë,
Me vepra Imani sixhadenë tjerr.
Nga meleqet në xhenet iu shtrohet,

"Mire se vini!", në xhenet iu thuhet.
Ata janë burrat e Imanit,
Drita e shpirti i Islamit.
Pa far ngurrimi jetën e japin,
Dyert e xhenetit me dritë i hapin.
Yjet e Islamit kurrë s'perëndojnë,
Në qiell të imanit vezullojnë.
Burrnia Islame kurrë s'shteron,
Prej Arshit të Rrahmanit ajo buron.
Nga Allahu të gjithë nderue,
Xhenetin Firdos iu ka premtue.
Madhështia e Osos atje ka mbërri,
Me Sahabe rri e me tjerë karshi.
Në shoqni të Pejgamberit t' gjithë janë,
Xhenetin e blen me vepër e Iman.
Me gjuhën e imanit shijuen dynjanë,
Mësues kishin Muhamed Mustafan.
Afër Pegamberit Ebu Bekiri,
Ndër Sahabet asht ma i miri,
Në se iamani i tij vihet në kandar,
Peshon ma randë se bota mbar.
Karshi Ymerit: burrit të drejtësisë,
Portës s' diturisë: Imam Alis.
E aty afër Osman ibn Affan,
Pronari i dy dritave atij i thanë.
Luani i shkretinës Hamzai vetë,
Për guxim, trimëri... vulë ka mbet
Selman el Farisi, Bilal Habashi,
Suhejb e Rrumi.e tjerë karshi.

Saad ibn Vakas, ngadhnyyesi i Axhamit.
Ai bashkë me tjerët të bijtë e Islamit
Strategu i famshëm ishte Khalidi,
Strategjia e tij gjeneral mahniti.
Çlirimtarit të Kudsit, Salahudin,
Ngadhënyesit të Stambollës, Sulltan Fetin..
Tarik bin Zijad, çelësi i Andalusit,
Dërmuesi i tatarëve, Sejfedin Kutusit.
Omar Mukhtar, luani i shkretisë,
Muxhahidi i shquem i popullit t' Libisë.
E shumë burra tjerë në xhenet Firdos,
Jetën me shehadet e kanë vulosë.
Me shpirtin e vetëmohimit breznitë ushqeni,
Burim frymëzimi gjithmonë do të jeni.
E dhatë jetën qe kurrë mos të vdisni,
Me dritën e flijimit gjithmonë do t' ndrisni.
Madhështia e juej nga Allahu vetë,
Qe jeta jonë kuptimplote të jetë.
Ajo duhet t' ushqehet qe kurrë mos t' venitet,
Shkallës s' imanit përherë të ngjitet.
Allahu ju nderoj në dynja e ahiret,
Insha-Allah shihemi në xhenet.
Oso Kuka selamet,
Në botë flakë, dritë në xhenet!

Burhan Aldin Fili
Michigan, 2008

SHUMICE MUSLIMANE NE SHQIPERI ME NUMER TE VOGEL XHAMIASH

Gazeta "Tirana Observer", ne nje numur te saj, ka botuar te dhe-na per numurin e objekteve fetare qe jane ne Shqiperi duke dhene edhe detaje per numurin e ketyre objekteve sipas secilit religjon .Te dhenat jane vertet befasuese, sepse lexuesi njihet me nje nunur te vogel xhamiash qe i perkasin shumices muslimane ne Shqiperi , Eshte e habitshme, kur 638 xhamiave jane perballe 1119 kishave ortodokse dhe katolike.Me 20% besimtare ortodokse, kisha ortodokse ka 425 kisha. Kurse, religjoni katolik, me 10% te popullsisë, ka 694 kisha .

70% e popullsisë, qe eshte muslimane, ka638 xhamia. Keto jane te dhena qe jane deklaruar nga vete institucionet fetare perkatese te secilit religjon . Shifrat dhe evidencat jane burime me vlere, per te plotesuar statistika dhe per te sherbyer, per te plotesuar punime dhe referenca studimore ose simpoziumesh. Por, pas kesaj te dhe-ne per numurin e veprave te kultit ne

vendin tone ,media ka pase pa tjetër edhe nje pikesynim tjetër qe te beje te njohur faktin se shtirja e infrastruktures fetare te krishtere ne Shqiperi eshte rritur ,per te qene e gatshme te prese besimtare e krishtere, qe po rritet dhe ata qe nuk kane lindur, sepse te konvertuarit ne te krishtere jane "Miza te bardha"ne hapësirat shqiptare si mbrenda ,ashtu edhe jashte Shqiperise londineze.Kurse infrastruktura e muslimaneve eshte e paket dhe krejt e pamjaftueshme, per te krijuar kushte per besimtare muslimane qe praktikojne ritet e fese se tyre,aq sa sot, ne mes te Tiranes, besimtare e shohin vehten duke u falur ne mes te pluhurit dhe baltes, sepse nje kryebashkiak ortodoks eshte betuar qe ne Tirane te mos kete xhami te madhe per muslimanet , por vetem kisha te medha per katolike e ortodokse me te cilet eshte i lidhir nga nena me katolike dhe nga babai me ortodokse. KMSH e deklaroi shifren e vogel te xhamiave , por duket se e kaloi ne heshtje bllokimin e ndertimit te xhamise se ma-

dhe ne Tirane.Arsyet e verteta, perse ka pak xhamia ne Shqiperi nuk dalin ne materjalin e botuar tek "Tirane Observer",sepse ajo ose nuk ka dijeni , ose nuk eshte e interesuar te thote te verteten , Ne po i ndihmojme lexuesit duke e informuar se pozita financiare e KMSH sot eshte e mjerueshme dhe ajo, me pronat qe ka lufton te mbijetoje ,ne nje kohe qe fondacionet e huaja dhe sidomos ata arabe u akuzuan per nje bum ndertimesh fetare dhe sot ata e kane braktisur Shqiperine, pasi u akuzuan edhe te lidhura me terrorizmin, akuze qe kurre nuk vertetohet , por mbetet vetem akuze qe merr vleren e nje denimi gjykate , kur eshte fjala per te ndaluar aktivitetin e tyre. Kurse, per kisha ortodokse dhe katolike parate duket se jane pa limit, deri sa ndertohen kisha edhe per brezat e ardhshem, sepse ne hapësirat e tyre te medha hyjne e dalin pak besimtare ne pritje per t'u mbushur ne nje kohe X.

Do te ishte normale qe vete KMSH te bente te ditur ne menyre publike arsyen e ketij inferjoriteti te muslima-

neve shqiptare qe kane nje numur kaq te vogel xhamiash, qe e verteta te kete karakter zyrtar dhe jo te jete subjektive dhe e hamendesuar, sepse keqkuptimet mund te kalojne edhe kufirin, duke penalizuar persona dhe institucione, jashte dhe mbrenda Shqiperise, te interesuar qe muslimanet shqiptare te falen me shume neper rruge, sesa neper shtepite e Allahut xh. qe jane xhamiat.Por, kufizimet dhe guret nen rrota, qe po u vene muslimaneve shqiptare, nuk jane te mjaftueshem, qe t'i nxerrin ,apo t'i largojne ata nga feja islame, deshire kjo aq e madhe per ata qe i sabotojne ndertimin e xhamiave ne Shqiperi. Muslimaneve mund t'u mungoje xhamiat dhe medrezete, por atyre nuk u mungon besimi tek Allahu xh.sh. tek i cili ata e gjejne mbeshtetjen dhe rrugedaljen edhe kur u mungojne xhamiat dhe falen ne mes te shiut dhe pluhurit

Alban Kastrati

PARTIA E KRYEMINISTRIT ERDOGAN KALON ME SUKSES GJYKATEN KUSHTETUESE

Sukseset dhe aritjet e qeverise aktuale turke te kryesuar nga kryeministri Taip Rexhep Erdogan krahas atyre qe I kane pershendetur keto aritje nuk kane qene te pakte ata qe kane qendruar ore te tera zgjuar duke bere plane si ta zbresin nga piadestali qeverine e suksesshme dhe partine nga eshte formuar kjo qeveri. Ata qe u tronditen shume ishin laiket qe ne Turqi kane nje tradite dhe baze te fuqishme qe lidhet edhe me karakterin laik te vete shtetit turk. Dhe pika ku u sulmua qeveria e Erdoganit dhe partia e tij ishte tek pozicioni I saj fetar I cili u amplifikua ne kuota te tilla sa u paraqit kjo parti si filo islamike dhe qe paraqet rrezik per karakterinlaik te shtetit turk. Akuzat moren karakter ligjor duke e drejtuar problemin ne Gjykaten Kushtetuese te Turqise me pikesynimin per ta nxerre te jashteligjshme partine e kryeministrit Erdogan dhe figurat kryesore te saj Erdogan dhe Abdulla Gylper t'i larguar nga politika dhe pse jo edhe per t'ia dhene drejtesise per ndjekje penale. Segmente te caktuara te ushtrise ishin mbeshtetes se kesaj nisme ecla nuk doli e suksesshme per ata qe e hartuan dhe e drejtuan per ne gjykate Kushtetuese. Ne nje vendim qe nuk vonoi te merret akuzat u hodhen poshte nga trupi gjykues dhe qeveria dhe partia qe ajo perfaqeson dolente fituar duke siguruar nje vazhdimesi te sigurte per zhvillimin e gjitheshem

te Turqise dhe duke u kujtuar segmenteve laike radikale se ditet kur ata benin ligjin i takonin te kaluaret.Akuza qe rendonte qeverine e Erdoganit sipas atyre qe iu drejtuan ligjit ishte se ajo I dha driten jeshile venies se shamise nga studentet ne universitet duke iu dhene nje te drejte qe vajzat universitare e kane ne te gjithë Evropën qe eshte shume me laike se Turqia.Ajo qe harrojne ata qe e ngriten problemin deri tek ana ligjore e tij eshte se kjo qeveri ka voten e popullit I civivotoi keto politikane me nje perqindje te larte duke treguar se masat e kesaj qeverie , reformat e saj net e gjitha fushat jane mbeshtetur nga populli turk I cili I mat premtimet me rezultate dhe aritje dhe nuk ka vendosur qe t;I kundervihet tradites islame dhe te mohoje gjithashtu edhe aritjet ekonomike qe ia kane ngritur prestigjin Turqise ne keto vite kur qeverise politikani I shkelqyer Taip Rexhep Erdogan. Te shqeteson fakti si e percollen mediat



shqiptare problemin qe trajtuam me siper. Per hir te se vertetes ata ferkonin duart ne pritje te nje permbyesjeje te situates politike ne Turqi, duke shpresuar se shamia do te fluturonte nga koka e studenteve turke dhe ato do te merrnin rrugen per t'u arsimuar neper Evrope ne mbrojtje te karakterit laik te shtetit turk, ku pas ketij arsye-timi fshihet urrejtja e verber kunder normave morale te fese islame.

Kete konkluzion ne e puplikojne sepse kemi parasysh trajtimin e nje-anthem qe i bene mediat shqiptare akuzave qe u bene per te rrezuar politiken qe drejton sot Turqine.

Ne deshrojme qe populli turk dhe bota te perkrahe nje Turqi te forte dhe moderne qe prek majat me te larta te ekonomise dhe te politikës boterore ,sepse nje aritje e tille do te jete nje mbeshtetje jetike edhe per Shqiperine dhe shqiptaret te cilet me Turqine dhe me turqit I lidh nje hark kohor 500 vjecar te cilin nuk mund ta levizin nga jeta e popujve tane as laiket ekstreniste te Turqise ,as mediat shqiptare dhe segmented politike dhe ekonomike qe fshihen pas tyre.

Besnik Dani

KONTRIBUTI I QYTETERIMIT ISLAM

Ajni Sinani

Qytetërimi islam është fryt dhe prodhim pikërisht i Fesë Islame, sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e Fesë Islame. Ngado, që ka arritur Feja Islame, ka arritur edhe ai qytetërim; çdo popull, që e pranoi Fenë Islam, në gjirin e tij u fut edhe ai qytetërim.

Në vazhdim, do të shohim kontributin e pamohueshëm të qytetërimin islam (që ngërthen pazbërthyeshmërisht edhe kulturën islame) dhe ndikimin e tij në qytetërimin perëndimor, si dhe perspektivat që u afron e ardhmja këtyre dy civilizimeve, në bazë të sistemit të besimit dhe të moralit mbi të cilat ngrihen këto dy qytetërimet. Por këtu, duhet të përmendim se, shpirti prometian dhe titanesk, që tregohet aq qartë, në pjesën më të madhe të artit të renesancës, qëndron diametralisht kundër shpirtit të Islamit, që mbështetet në përlulje ndaj Zotit. Vërtet, shkenca dhe kultura islame, qenë faktorë për ngritjen e Renesancës në Perëndim, por elementet u shkëputën nga kuptimi dhe rëndësia e tyre e plotë.

Qytetërimi hindus, kinez dhe japonez janë të ngushtuara në rajone të caktuara gjeografike dhe, në panoramën aktuale, zënë vend si sisteme të besimit dhe mënyra jetese, pa pretendime universale. Në panoramën aktuale, në sy, na bien dy qytetërimet, që shënojnë ngritje: qytetërimi islam dhe ai perëndimor.

Nëse lexon libra, që përshkruajnë historinë e kombeve, lexuesi do të hasë, në historinë e kombeve perëndimore, përshkrime në detaje e me ngjyra të gjalla, ndërkohë, që gjen vetëm një kundrim sipërfaqësor, për pjesët e tjera të botës, duke iu nënshtruar kështu iluzionit, se: "e tërë bota është krijuar vetëm për perëndimin dhe civilizimin e tij, ndërsa civilizimet e tjera kanë qenë të përcaktuara vetëm për të formuar një kornizë të përshtatshme, për tërë atë famë perëndimore dhe si pasojë, në shpirtin e popujve jovevropianë, krijohet ndjenja e inferioritetit ndaj kulturës dhe mundësisë të tyre personale."

Evropianët kanë pohuar deri vonë se, qytetërimi i sotëm, ka lindur drejtpërdrejt nga qytetërimi i vjetër grek. Qytetërimi grek është më i vonshmi i qytetërimeve të lashta, si: kaldease, asirase, midiasë, indase, egjiptase etj. Qytetërimi perëndimor, në mendjen e individëve të qytetërimeve të tjera, mbjell tezën se ai është qytetërimi i vetëm që e rrethon dhe përfshin edhe të kaluarën edhe të ardhmen. Kjo paradigmë, e përhapur me përmasa botërore edhe në librat shkollorë, bëri që qytetërimi perëndimor të admirohet si një e vërtetë absolute.

Historiani i njohur, Jacques Le Goff, midis të tjerash shkruan: "Bota, në çdo epokë, ka vetëm një zemër në harmoni me të cilën, jeton pjesa tjetër e universit. E ngritur mbi ekzogjezën orosiane të ëndrrës së Danielit, vazhdimësia e perandorive, nga babilonasit te medeasit dhe te persët, pastaj te maqedona-

sit dhe pas tyre te grekët dhe romakët, përbën parimin, që udhëheq filozofinë mesjetare të historisë. Ajo, vepron në nivel të dyfishtë: në atë të forcës dhe në atë të qytetërimit. Mbartja e pushtetit, translatio imperii, është mbi të gjitha një mbartje e diturisë dhe e kulturës, translatio studii...Ajo thekson ngujimin e qytetërimit të krishterë, duke hedhur tej qytetërimet bashkëkohore, bizantine, muslimane, aziatike." Koncepti i historisë, që ka edhe atë ariane, të cilat qytetërimi perëndimor i konsideron si rrënjë të veta, që ka vazhduar me Romën dhe feudalizmin dhe që ka arritur në epokën moderne përmes Renesancës dhe Reformacionit, bëri që të gjithë librat e mendimit filozofik, ekonomik dhe politik, të shkruhen duke marrë për busull konceptin perëndimor. Në këtë mënyrë, individët e pellgjeve të qytetërimeve kineze, indiane dhe islame, vendosen brenda kornizave të konceptit perëndimor, me përkushtëzimin se qytetërimet e tyre, nuk i kanë dhënë kurrfarë kontributi historisë së njerëzimit. Orientalistja e njohur gjermane, Zigrig Honke, në librin e saj të njohur: Dielli arab lind mbi Perëndim me një objektivitet të thellë, tregon kontributin e jashtëzakonshëm të qytetërimit islam. Kjo gjermane, pranon gjithashtu fshehjen e faktit, rreth rëndësisë dhe mundit civilizues të arabëve, nga ana e shkencëtarëve evropianë, duke thënë:

Edhe përkundër rëndësisë dhe kontributit të arabëve, kush lexon njëqind libra historikë, në nëntëdhjetë e tetë prej tyre, nuk gjen të jetë përmendur ndonjë emër arab." Ajo gjithashtu shkruan: "Pika e shikimit të shekujve të Mesjetës ende nuk ka vdekur; edhe sot e kësaj dite, ekziston një grup njerëzish, me horizonte të kufizuara, larg nga toleranca fetare, i cili ndërton penda dhe pengesa përballë dritës". Është e papranueshme, që të pajtohemi me faktin se, në periudhën 10 shekullore, në mes qytetërimit grek, që është më i vonshmi i atyre qytetërimeve të lashta dhe qytetërimit të sotëm evropian, rruzulli tokësor ka mbetur i zhveshur dhe pa qytetërim. Përkundrazi, kjo periudhë, ka qenë e stolisur me qytetërimin më të plotë dhe më të përsosur, që është QYTETËRIMI ISLAM. Qytetërimi islam është fryt dhe prodhim pikërisht i Fesë Islame, sepse ky qytetërim është paraqitur bashkë me paraqitjen e Fesë Islame. Ngado, që ka arritur Feja Islame, ka arritur edhe ai qytetërim; çdo popull, që e pranoi Fenë Islam, në gjirin e tij u fut edhe ai qytetërim. Islami ishte dhe mbeti një fuqi kozmike, që arriti ta nxjerrë botën nga errësira në dritë, sistem shoqëror, që rregulloi të gjitha aspektet e jetës së njeriut dhe, fuqinë e tij krijuese, e orientoi kah të mirat dhe mirëqenia. Ai ishte dhe mbeti një forcë aktive, që vepron edhe sot, në realitetin e kësaj bote. Me shfaqjen e Islamit, filluan të vendosen themelet e një civilizimi të ri. Drita islame, filloi të ndriçonte viset e ndryshme të botës. Filloi një jetë e re. John W. Draper thotë: 'Islami, gjatë gjithë kohës, pasoi shkencën fizike. Ndër-

kaq, Krishterizmi pagan, jo vetëm që e hodhi poshtë këtë shkencë, por shprehu përbuzje të thellë dhe urrejtje ndaj saj. Mjekët shiheshin, nga Kisha, me sy jo të mirë dhe njerëzit i konsideronin të pafe.' Sipas Garodit 'muslimanët e parë, duke iu falënderuar asaj fryme të hapët, në të cilën thërret Kur'ani në çdo faqe të tij, janë përpjekur të përkthejnë, të përshtatin dhe të integrojnë kontributet më të vlefshme të Indisë, Bizantit, Greqisë, Iranit, prej matematikës, gjer në medicinë. Ndërkaq, kanë ditur, që thesarin shkencor, me themel, ta mendojnë që t'i japin kuptim të ri, në perspektivë të fesë islame, dhe kështu muslimanët u bënë, jo vetëm bartës të diturisë së vjetër të gjithëmbarshme, por krijues të një kulture, e cila gjatë shumë shekujve u bë pishtar i tërë botës.' Muhamed Ikbali thotë: 'Pika e parë e rëndësishme, që duhet pasur parasysh, në aspekt të frymës së kulturës islame është, që ai ka fiksuar, në aspekt të njohjes, shikimin e vet në konkretin, përfundimtarin. Është e qartë, pos kësaj, se prejardhja e metodës së eksperimentimit dhe kundërimit, në Islam, nuk është borxh ndaj kompromisit me mendimin grek, por me luftimin e gjatë intelektual me të.'

Autori i veprës 'Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar', historiani i njohur, Jacques Le Goff, jo për shkak të simpatisë, por për shkak të objektivitetit, veç të tjerash shkruan: 'Në kulmin e kryqëzatave, shkenca arabe derdhet mbi Krishterizmin dhe, nëse ajo nuk e shqetësoi, të paktën e ushqeu atë, që ne e quajmë Rilindja e shekullit XII. Ajo çka, arabët u dhanë dijetarëve të krishterë, me thënë të vërtetën, është para se gjithash shkenca greke, e grumbulluar në bibliotekat orientale dhe e vënë në qarkullim nga dijetarët muslimanë, të cilët e përhapën deri në skaj të Islamit perëndimor, në Spanjë (Andaluzi). John Davenport, dijetar i shquar, thotë: 'Duhet të pranojmë se e tërë dija në fushën e fizikës, astronomisë, filozofisë, matematikës, që u përhap në Evropë, duke filluar nga shek. X-të, buron nga shkollat arabe. Madje, saraçenët (muslimanët) e Spanjës, mund të konsiderohen si etër të filozofisë evropiane.'

Bertrand Rasel, filozof i famshëm anglez, thotë: 'Faza, shekujt e errët të Mesjetës, ndërmjet shek. 7-10, ka të bëjë vetëm me Evropën. Në atë kohë, prej Indisë deri në Spanjë, shkëlqente qytetërimi Islam. Prandaj, është pasaktësi të flitet, vetëm mbi qytetërimin e Evropës.' Sami Frashëri, thotë: 'Evropianët, pasi nuk kishin fare njohuri mbi qytetërimin e lashtë grek, vazhdonin të mësonin në shkollat e porsahapura të Andaluzisë. Bile aty, ata mësuuan edhe emrat e dijetarëve të vjetër grekë, si dhe shumë vepra të tyre të humbura, i morën nga përkthimet që gjendeshin në gjuhën arabe.'

Muhamed Asad, shprehet: 'Para syve të verbuar, të dijetarëve e mendimtarëve evropianë, u paraqit një civilizim tjetër- i rafinuar, progresiv, përplot jetë, pasionant dhe me posedim të pasurive

kulturore, që Evropa i kishte harruar prej kohësh. Ajo, që bënë arabët ishte më tepër se ringjallje e diturisë së lashtë greke. Ata, kanë krijuar botë plotësisht të re shkencore të tyre vetjake dhe hapën, deri atëherë, rrugë të panjohura të hulumtimit dhe të filozofisë.' Klarku, profesori i historisë së artit, është i detyruar të pohojë, se: 'Teposhtëza e qytetërimit mund të ketë zgjatur shumë kohë, por në mes të shekullit të shtatë u shfaq një forcë e re, që kishte besim, energji dhe vullnet për të ngadhënjyer si edhe një kulturë alternative - Islami. Fuqia e Islamit, fshihej në thjeshtësinë e tij. Kisha e hershme e krishterë, e pat shkapërdarë fuqinë e vet, në zënkat dhe grindjet teologjike, që vazhduan për tre shekuj me një duf dhe me sajësia të pabesueshme. Por, Muhammedi (a.s.), profeti i Islamit, predikonte një doktrinë më të thjeshtë, që u pranua menjëherë dhe u dha pasuesve të saj, atë ndjenjë solidariteti të pathyeshëm, që u pat prirë dikur legjioneve romake. Brenda një kohe çuditërisht të shkurtër - rreth pesëdhjetë vjet - bota klasike, u nënshtrua. Vetëm eshtrat e saj të zbardhura, zbuloheshin në sfondin e qiellit mesdhetar.'

Këtë e thekson edhe Joshua S. Goldstein, kur thotë: 'Kur Evropa ndodhej në "periudhën e errësirës", qytetërimi arab (islam A.S.), ishte në periudhën e tij të artë. Ai, thekson se "Perandoria e madhe arabe e periudhës së viteve 600-1200 luajti një rol të veçantë. I gjithë rajoni i Lindjes së Mesme, ka qenë i bashkuar nën këtë perandori, që lindi dhe u përhap së bashku me fenë islame.'

MUrad Hofman thotë: 'Muslimanët, arritën rezultate epokale, në të gjitha fushat e artit dhe shkencës, duke inkuadruar matematikën, optikën, botanikën, kirurgjinë, oftalmologjinë, higjienën, leksikografinë, historinë, sociologjinë. Në këto dhe në lëmenj të tjerë, civilizimi islam, hijesoi civilizimin perëndimor, prej shekullit të nëntë deri në shekullin katërmëdhjetë. Në këtë kohë, kemi personalitetet më të shquara të kohës, sikurse janë: Razi (Rhases), Biruni, Ibën Rushdi (Averroes), Ibn Sina (Avicena), Ibën Halduni, Ibën Batura, Havarizmi etj.'

Në të vërtetë, trashëgimia greke e përzier me trashëgiminë arabo-islame, është ajo e cila arriti në Evropë, dhe e ndihmoi atë të dilte prej injorancës të saj të errët të Mesjetës, në atë që njihet me kohën e Renesancës.

Ekzistojnë me dhjetëra e dhjetëra libra të studiuesve të ndryshëm islamë, që venë në pah me argumente dhe fakte të pamohueshme, ndikimin e civilizimit islam, rrezet e para të të cilit filluan, prej gadishullit Arabik dhe që, pas pak kohësh "u shndërruan në diej, që shndritën hapësira të gjera, nga pjesa lindore e rruzullit tokësor, e deri në pjesën perëndimore, duke përfshirë popuj të civilizimeve të ndryshme, civilizim ky, minaret e të cilit u ngritën mbi shkencë, filozofi, letërsi, art..."

Muaji i agjërimit

Vërtetë që Allahu i ka falur ata të cilët malli i ka marrë për te bërë vepra te mira, dhe mjerë për ata që kanë mbetur në mëshirën e fatit, në detin e injorancës, në sofrën e mëkateve.

Falënderimi i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij falje dhe mëshirë kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje nga Krijuesi prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona të liga. Më i lartësuar është Allahu që agjërimitin na ka bërë obligim dhe përmes tij të synojmë devocionin (takvallëkun). Kë e udhëzon Allahu s'ka kush e lajthit dhe kë e largon nga rruga e vërtetë, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër përveç Allahut, i Cili është Një dhe dëshmoj se Muhammedi alejhisselam është rob dhe i dërguar i Tij.

Të dashur vëllezër besimtarë. Është fat i madh të takohemi përsëri me muajin e bekuar, muajin e mëshirës, bereqetit dhe sakrificës, muajin e faljeve te mëkateve, muajin në të cilin zbritën librat e shenjtë, Tevrat, Ingjili, Zeburi, fletushkat e tjerë, si dhe Kur'ani Famëmadh.[1] Ky është muaji në të cilin u zhvillua lufta e bedrit, muaj në të cilin ndërjuan jetë axha i Muhammedit alejhisselam dhe gruaja e tij, Hadixheja radijallahu anha, gjithashtu edhe Mekka u çlirua gjatë muajit të agjërimit. Sa te lumtur që përsëri arritëm te takohemi me muajin e veçant, të cilin Allahu Fuqiplotë e veçoi me natën e Kadrit, muaj që nuk ka të krahasuar me asnjë muaj nga muajt e vitit.

Vërtetë që Allahu i ka falur ata të cilët malli i ka marrë për te bërë vepra te mira, dhe mjerë për ata që kanë mbetur në mëshirën e fatit, në detin e injorancës, në sofrën e mëkateve. Ejani vëllezër, ta falënderojmë Allahun e Plotfuqishëm për begatitë që na ka dhuruar, për muajin e bekuar që na ka bërë te mundur për ta takuar; ta përkujtojmë në të Krijuesin e te gjitha krijesave, Mëshiruesin e të gjitha botërave, atyre që shohim dhe nuk i shohim, të përfitojmë nga ky muaj atë që kemi lënë mangu në vitet e kaluara, të veprojmë vepra te mira, gjithnjë më qëllime të mira, të shfrytëzojmë rastin që gjatë këtij muaji të japim maksimumin si në vepra, po ashtu edhe në punë te mira, te bashkohemi, të vizitohemi me të afërmit, të përgatisim ushqime për të varfërit, t'i ndihmojmë bonjakët, t'i vizitojmë invalidët e luftës, t'i pastrojmë zemrat tona nga ndryshku i xhelozisë, inatit dhe kopracisë, t'i falim ata që na kanë dëmtuar, t'i ftojme te varfrit në iftare, t'i mëshirojmë te moshuarit, t'i edukojmë te vegjlit. Ejani vëllezër te lexojmë Kur'anin, te falim namazet sëbashku me xhemat. Ejani te nderuar besimtarë, ta falënderojmë te Gjithmëshir-

shmin për këtë muaj te agjërimit si dhe për begatitë e tij.

Vëlla besimtar,

Përpiqu që gjatë këtij muaji t'i kryesh obligimet, e veçmas agjërimitin, mundohu që t'i japësh hakun aq sa ke mundësi. Allahu i Madhëruar na ka urdhëruar në suren el-bekareh, ku thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” ([2])

Vëllezër besimtarë, kjo është mirësia që Allahu e dëshiron për mbarë njerëzimin. Ramazani na trajnon që gjithherë te veprojmë mirë; na mëson se si të tregohemi dashamirës ndaj te tjerëve, njëherazi na përkujton fushatën e rritjes se imanit dhe forcon anën shpirtërore te njeriut. Pra, ky është qëllimi kryesor i agjërimit. Ne nuk agjërojmë thjesht që t'i rezistojmë etjes dhe urisë. Muaji i agjërimit nuk është vetëm te falim namazin e teravive, apo namazin e natës. Ajo që kërkohet nga ne është se, në çdo adhurim që kryejmë përgjatë këtij muaji, duhet shikuar përtej anës se jashtme se kryerjes se ritualeve. Po ashtu, duhet kështu kujdes te veçantë se, adhurimet e kryera duhet te na ndërtojnë ne në një mysliman te gjallë, dinamik, mysliman me plot kuptimin e fjalës; mysliman me plot iman; te jemi shembullor dhe individ energjik. Agjërimi nuk duhet kuptuar si një muaj i vetëm për ta adhuruar Allahun, siç ndodhë me shumë myslimanë, ku gjatë muajit te agjërimit bëjnë vepra te mira, dhe më të kaluar të këtij muaji, kthehen përsëri ne mëkate dhe vazhdojnë jetën e tyre te mëparshme ne mëkate dhe armiqësi. Agjërimi posedon qëllimet e veta. Myslimani duhet ta kuptoj se agjërimi forcon besimin dhe ndërton frikërrespektin ndaj Krijuesit; ndërton karakterin dhe sjell forcë dhe fuqi për t'i anashkaluar sfidat te cilat përcjellin myslimanin gjatë jetës se tij.

Vëllezër besimtarë

Ejani ta shfrytëzojmë çdo orë te këtij muaji, ta forcojmë besimin tonë, t'i kryejmë obligimet ashtu siç ka porositur Allahu i Madhërishtëm. Te fillojmë me vetën tonë, t'i kushtojmë rëndësi anës se jashtme në përgjithësi dhe asaj shpirtërore në veçanti. Te ruhem nga çdo e metë, te kemi kujdes se si te veprojmë me gjymtyrët tona, ku shkojmë, çfarë hamë, çfarë flasim, dëgjojmë, shikojmë, shkelim, te gjitha këto hynë në llogari ditën e gjykimit. Ajo që na duhet gjatë këtij muaji është ndryshimi i vetes sonë, e me pas t'i këshillojmë te tjerët.

Fillimisht, jemi te obliguar që para se të fillojmë një punë, te posedojmë nijetin e pastër; te jemi te sinqertë në

atë që themi dhe veprojmë. Ne këtë muaj te mëshirës, te nxitojmë drejt kryerjes se adhurimeve, ibadeteve me sinqeritet. T'i kryejmë të gjitha për hirë të Allahut, e jo për qëllime fitimprurëse, apo për tu shtirë si besimtar. Vetëm me sinqeritet mund te arrihet sukcesi, andaj me zemër te çiltër dhe qëllim te pastër, jemi te obliguar që te veprojmë vetëm vepra te mira. Ne lidhje me këtë, Allahu xh.sh në suren El-Bejneh thotë:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të sinqertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zeqatin, se ajo është feja e drejtë.” ([3])

Gjatë këtij muaji duhet te luftojmë që gjithsesi në mendjet tona te zë vend morali dhe sjelljet e mira. Ta marrim si shembull Pejgamberin e fundit Muhammedin [alejhisselam], i cili gjithmonë ishte dhe mbeti shembull për gjeneratat që erdhën pas tij. Ai na tregoi se si duhet te jetë morali i myslimanit. Kjo është diçka e pamohueshme dhe nuk ka pikë dyshimi në te. A ka diç më të mirë në këtë botë kur të lavdëron Krijuesi i Gjithësisë? Vërtetë që po mos të ishte shembull për te mirë, Allahu nuk do ta kishte përmendur këtë lëvdatë mbi moralin e Muhammedit [alejhisselam], Ai në Librin e Tij famelart thotë:

“Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vie rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndijshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.” ([4])

A keni menduar ndonjëherë, përse Islami na nxit te mobilizohemi me moral të mirë? A kemi pyetur veten ndonjëherë se çfarë do te kishte ndodhë me atë person, i cili nuk posedon moral dhe karakter te mirë? Si do te ishte halli i tij? Çfarë do te flitej për te? Jam i bindur se morali dhe karakteri i mirë janë tejet te rëndësishme për ndërtimin e një shoqërie te shëndoshë. Pa dyshim se askush nuk do te pajtohej te jetoj dhe te ndërtoj jetën në një vend apo shoqëri te degjeneruar. Vëllezër besimtarë, tashmë kuptuam se çfarë vlere ka morali, për këtë edhe themi se feja islame është fe që njeriut i sjell te mira, bereqet dhe lumturi në jetë, prandaj ta ndërtojmë një shoqëri me baza te shëndosha, duke filluar themelet e saja ne këtë muaj te rëndësishëm.

Si ta shtojmë besimin, devotshmërinë dhe sjelljet e mira?

Për ta shtuar besimin dhe devotshmërinë si dhe për tu pajisur me moral te mirë, duhet qe fillimisht te shtojmë edhe njohuritë, njohuri te cilat do t'i sjellin dobi mbarë njerëzimit.

Feja Islame si fe universale, qe nga fillet e saja, ka porosit qe në mënyrë te vazhdueshme te kërkojmë dituri. Kur njeriu kërkon dituri, arrin grada te larta në këtë dhe botën tjetër, në lidhje me këtë, Allahu xh.sh thotë:

“.....All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri....” ([5])

Pasi që gjendemi në muajin e agjërimit dhe leximi i Kur'anit është i domosdoshëm, te mos harrojmë se përveç leximit, rëndësi duhet kushtuar edhe kuptimit te ajeteve dhe pas arrijtes se njohurive, t'i mësojmë te tjerët, ta shpërndajmë atë që kemi mësuar, vetëm në këtë mënyrë do te arrijmë suksesin e garantuar dhe me këtë gjest do te jemi me afër Kur'anit.

Mos te harrojmë se leximi i Kur'anit ka qenë lindës i ideve, zbulimeve dhe inovacioneve te ndryshme për njerëzimin. Kur'ani është libër i shenjtë dhe nga ai mund te mësojmë çdo ditë gjëra te reja, aq me shumë qe te lexojmë, aq me tepër do të kuptojmë kuptimet dhe komentimet e tij. Kur'ani nuk duhet lexuar ashtu sikurse lexohet gazeta, ai duhet te lexohet dhe te meditohet, kuptimet e tij te studiohen dhe nëse veprojmë kështu, padyshim se agjërimi, kur'ani, namazi, zeqati, do të formojnë individin dhe do te vërehet se asnjëra pa tjetrën nuk mund te jetojnë. Poqe se zbatojmë Kur'anin dhe veprojmë sipas tij, padyshim se do te ketë avancim ne jetën tonë dhe kurrë nuk do te mbetemi prapa, prandaj, duke zbatuar obligimet ashtu siç i ka hije myslimanit, kërkohet edhe durimi, pasi që durimi na shpie deri te arritja e suksesit. Vëllezër besimtarë, se fundi këshilloj veten, e me pas ata te cilët dëgjojnë dhe lexojnë këtë temë se, elementi kryesor gjatë këtij muaji është durimi, vetëm duke bërë sabër, sigurojmë edhe shpërblimet mbi kryerjen e adhurimeve (ibadeteve) tona. Po ashtu, te përpiqemi maksimalisht që gjatë këtij muaji ta përmirojmë vetën tonë, familjen, te afërmit; te përfitojmë nga te mirat që sjell ky muaj. Te mobilizohemi me moral te mirë, pa marrë parasysh vendin ku jetojmë dhe rrethanat. Te jemi te durueshëm. Ta vëzhgojmë anën e jashtme dhe atë te brendshme. Te falemi dhe te punojmë ashtu siç ka porositur Krijuesi i kësaj Gjithësie.

Në fund lusim Allahun e Plotfuqishëm te na i fal mëkatet tona dhe te na bëjë prej vepërmiëve, durimtarëve dhe te jetë i kënaqur me agjërimitin dhe ibadetet tona. Amin.

Mr. Fehim DRAGUSHA

Bismill-Lahirr-Rrahmanirr-Rrahime
Tregtojme MISH HALLALL
 E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

Produkte Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
 VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
 MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

- 1- Produkte mishi hallall si: sallam, suxhuk etj.**
- 2- Piceri hallall**
- 3- Fast Food hallall**

Ju keni të drejtë të blini ku të doni por hallalli i vërtetë është vetëm tek market "ISMETI"

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
 Cel: 0692101893

Adresa: Pranë bankës arabe në Shkodër
 Mobil: +355 69 20 72142
 E-mail: arditbilani@yahoo.com

Ardit Bilani

Punime artizanale me forma dhe madhësi nga me të ndryshmet,
Adresa: Souvenir Shopping House, Prane Bankes Arabe